

## **RELACION**

### **MBI DOMOSDOSHMERINE E ZBATIMIT TE PROJEKTIT "VENDOSJE TUBACIONESH NE KANALIN VADITES KUTURMAN - MARINAJ"**

Fshatrat Kuturman dhe Marinaj , bejne pjese ne Njesine Administrative Qender te Bashkise Librazhd, Keto fshatra me rrreth 2100 banore ku aktiviteti i vetem i tyre eshte bujqesia dhe blektoria ,te cilet zoterojne nje fond bujqesor prej rrreth 380 ha. Ku rrreth 80% e saj shfrytezohet sot per kultura te ndryshme bujqesore . Theksojme se keto dy fshatra nuk jane prekur nga levizjet masive apo zhvendosjet e banoreve ne vende te tjera. Edhe pse shfrytezohet nga fermeret ne nje mase te madhe nuk arrihet te merren prodhimet ne masen e pritur dhe te mundshme si rezultat I faktorit te mungeses se vaditjes se saj. Ne periudhen e ish kooperativave bujqesore keto dy fshatra siguronin rendimente te larta te prodhimeve bujqesore duke qene nder te paret ne fshatrat e rrrethit , ku vetem drithera prodhoheshin mbi 7000 kv ne vi , ndersa sot jo vetem buka por edhe baza ushqimore per blektorine blihet. Vaditja realizohet vetem nepermjet kanali te Kuturmanit I cili furnizohet nga Gurra e Gurakuqit.

Ky kanal ka nje gjatesi prej 18.5km dhe nje amortizim te madh. Ky kanal per rrreth 7 – 8 vjet me rradhe ishte jashte funksionit nga amortizimi I tepert por dhe nga mos investimi duke lene pas dore dhe perdonimin e tokes, duke rrezikuar per tharje blloqe pemtoreje pa llogaritur kulturat e tjera bujqesore. Pas vitit 2012 ky kanal u rihu ne pune por kapaciteti ishte shume i vogel per aresye te demtimeve te parikuperueshme .

Rikthimi I vemendjes se fermereve tek shfrytezimi I tokes ka cuar ne domosdoshmerine e investimit ne kete kanal per te rritur kapacitetin e tij dhe per ti dhene jete tokes se ketyre banoreve. Serisht ky kanal eshte vene ne rrezik mosfunksionimi qe e ben mese te domosdoshme nderhyrjen ne rikonstruksion te tij.

Nga ana e specialisteve u verifikuan shkaqet qe ndikojne si dhe mundesite per te rritur kapacitetin e ketij kanali si dhe per ta vene ne funksion te plete.

Pas nje studimi eshte arritue ne konkluzionin e meposhtem :

Ne pjesen e pare te kanalit ne nje gjatesi prej 2.42km ku futet vepra e marrjes dhe deri tek Sifoni i Madh (Perballe Lagjes se Rucit) kanali ka demtime te pjesshme dhe nevoje per nderhyrje nga komuniteti, pasi pjeserisht kemi te bejme me nje profil me elemente dretkendesh betony te ruajtura ne forme por qe kane nevoje per pastrim dhe mirembajtje te pervitshme dhe pjesa tjeter ka nevoje per pastrim qe merret persiper nga komuniteti.

Pjesa e dyte nga dalja e sifonit te madh deri ne hyrjen ne sifonin e Shotit ka nje problematike me te madhe pasi edhe pse pastrohet cdo vit kemi humbje te konsiderueshme nga formacioni shkembor ne te cilin kalon kanali si dhe nga segmente te rreshqitjes se tokes qe nuk mund te shmanget. Ketu po te shtohen edhe humbjet nga avullimi, ben qe ne dalje te sifonit te Shotit te kemi nje prurje jo te pranueshme per kapacitetin qe mban ky kanal si dhe per nevojat qe kerkohen te plotesohen.

Nga studimi I bere eshte pranuar variant I devijimit te linjes dhe zevndesimi me tubacion metalik Ø300 mm I cili redukton gjatesine e kanalit ne mases 1.2 km nga nje gjatesi 3.75 km ne gjatesine 2.55 km. nga ana tjeter parashikon rritjen e prurjes ne dalje te sifonit te Shotit nga 80 l/sej ne 120 litra /sek. Humbjet gjatesore ne tubacion jane te paperfillshme ne krahasim me humbjet aktuale. Ne pjesen tjeter te kanalit ne nje distance prej 8.8 km nga dalja e sifonit te Shotit deri ne lagjen Alla te Kuturmanit ku dhe fillon vadirja kemi te bejme me nje kanal te amortizuar por qe me kontributin e komunitetit mund te kemi nje permiresim te dukshem te efektivitetit te ketij kanali gje qe perseri komuniteti merr persiper mirembajtjen dhe pastrimin e pervitshem te ketij segmenti.

Ky variant ka ane pozitive pasi nuk kerkon shpenzime per mirembajtjen e metejshme.

PERGATITI : DREJTORIA E PLANIFIKIMIT ZHVILLIMIT TE  
TERRITORIT

